



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.4.1-2017-06

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
ISTOGUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të (Komunës së Istogut), në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha Udhëheqës Ekipi dhe Fanol Hodolli, Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Istogut për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 21/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Istogut.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Nga kategoria e Investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht 116,491€, për projekte të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime si dhe subvencione;
- Në regjistrin e pasurisë nuk janë regjistruar ende 1,540 parcela të tokës komunale; dhe
- Regjistri i pasurisë nën 1,000€ (e-pasuria) nuk është përditsuar ende me të dhënat e pasurive të viteve paraprake në sektorin e Shëndetsisë dhe Arsimit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Istogut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuate. Komuna ka klasifikuar gabimisht si investime kapitale, pagesat

për projektet¹ në vlerë 116,491€, të cilat sipas Udhëzimit Administrativ 2005/08 i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbime në vlerë prej 88,255€, dhe subvencioneve në vlerë prej 28,236€.

Pasuritë komunale vazhdojnë të jenë të nënvlerësuara, si pasojë e mos regjistrimit të 1,540 parcelave të tokës në pronësi komunale. Me tutje regjistri i pasurisë nën 1,000€ nuk është i saktë, pasi që blerjet e viteve paraprake për sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit ende nuk janë përfshirë në regjistrin E-pasuria.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Istogut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

¹ Përkrahja e bletarëve me shoqëri bletësh dhe koshere; Ngritja e serave; Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve (pastrimi i borës dhe mbeturinave); dhe Mirëmbajtja e parqeve dhe eliminimi i mbeturinave.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për thesarin, përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime të shpalosjet të cilat nuk kanë ndikuar në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipërpërmendur si theksim i çështjes, te opinioni i auditimit jepet rekomandimi, si:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe janë marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve si dhe te shpalesjet e pasurisë. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël. Me tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash përfshirë të hyrat dhe shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë procedurat e prokurimit ku në disa raste nuk janë duke u zbatuar kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, raportimi dhe pagesa e obligimeve si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,357,206	9,825,750	8,853,886	8,846,553	8,878,415
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,130,511	8,130,512	7,734,102	7,865,277	7,711,699
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	412,639	333,027	145,246	391,906
Të hyrat vetjake ⁴	1,226,695	1,226,695	751,223	721,525	742,835
Donacionet e brendshme	-	55,901	35,534	24,334	31,975
Donacionet e jashtme	-	3	-	90,171	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 468,544€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve prej 55,904€ si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 412,639€.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

³ Të hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 8,853,886€, me një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2016 (96%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,357,206	9,825,750	8,853,886	8,846,553	8,878,415
Pagat dhe Mëditjet	5,799,714	5,805,379	5,638,899	5,675,925	5,519,858
Mallrat dhe Shërbimet	853,700	893,054	764,047	782,425	810,343
Shërbimet komunale	117,000	119,598	118,580	145,532	161,046
Subvencionet dhe Transferet	223,813	296,916	262,018	201,391	327,545
Investimet Kapitale	2,362,979	2,710,803	2,070,342	2,041,280	2,059,623

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 5,665€. Realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte 97%;
- Po ashtu rritja e buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 39,354€ në kategorinë mallra dhe shërbime dhe 73,102€ për subvencione. Realizmi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 86%, ndërsa në kategorinë subvencione dhe transfere 88%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 347,824€. Rritja është si rezultat i të hyrave të bartura prej 292,923€, dhe granteve të përcaktuara të donatorëve prej 56,901€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit 2017, vetëm 76% e buxhetit ishte shpenzuar. Vonesat kanë të bëjnë me disa projekte të filluara në fund të vitit 2017.

Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale

E gjetura Sfidë e mëtutjeshme e komunës mbetet niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, në vetëm 76%, duke rezultuar më një suficit prej mbi 600 mijë €. Niveli i ulët i realizimit ishte kryesisht si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Me tutje, një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve ishin realizuar në tremujorin e fundit, te investimet kapitale 63% dhe te mallrat dhe shërbimet 43%.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Istogut në 2017 janë në vlerë 843,036€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 ⁵ Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,226,695	1,226,695	843,036	1,061,435	941,133
Totali	1,226,695	1,226,695	843,036	1,061,435	941,133

Tatimi në pronë i faturuar gjatë vitit 2017 ishte 348,493€, prej tyre janë arkëtuar 173,665€ apo 50%. Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë Komuna e Istogut kishte edhe të hyra indirekte nga dënimet në trafik dhe gjobat në vlerë 136,323€.

⁵ Pranimet për vitin 2016/2015 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

Çështja 3 – Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

- E gjetura** Komuna nuk ka bërë verifikimin e 1/3-së të pronave, sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2011 nenit 13. Nga 10,405 prona të evidentuar në bazën e të dhënave mbi tatimin në pronë, komuna ka arrit të verifikoj vetëm 395 prona aktuale të regjistruara, ose vetëm 4%.
- Rreziku** Verifikimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale, dhe ndikoj në vlerësim jo të saktë të hyrave për tatimin në pronë.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave të paluajtshme për qëllim të tatimit në pronë duhet të bëhet sipas rregullave, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja 4 – Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira

- E gjetura** Komuna ka dhënë me qira 61 prona komunale për shfrytëzim të përkohshëm, duke anashkaluar procesin e ankandit publik, si dhe përcaktimi i çmimit të qirasë në këto raste nuk është bërë në përputhje me Rregulloren Nr. 23/2013. Gjatë këtij viti, 36 shfrytëzues të pronës komunale, nuk kanë paguar fare qira dhe komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim për inkasimin e këtyre mjeteve. Për më tepër, në 11 raste kontratat për shfrytëzim të pronës nuk ishin valide, pasi që ka skaduar afati i kontratës. Vetëm në një rast gjatë vitit 2017 është vazhduar kontrata për shfrytëzimin e pronës duke u thirrur në ligjin e vjetër, i cili ishte shfuqizuar kohë më parë.
- Rreziku** Dobësitë e identifikuar mund të rezultojnë me konkurrencë të limituar apo me më pak të hyra nga kjo kategori dhe trajtim jo të barabartë të palëve me rastin e përcaktimit vullnetar (paushall) të çmimeve. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin e të hyrave nga qiraja dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave. Gjithashtu edhe operimi me kontrata të skaduara privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarve gjyqësore në raste të mos inkasimit të borxhit me kohë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.

3.3 Pagat dhe shtesat

Komuna ka arrit ta shfrytëzoj 97% të buxhetit final për paga dhe shtesa të cilat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Kontrollat kyçe që aplikon komuna janë monitorimi dhe nënshkrimi i listave të pagave nga zyrtaret kompetent.

Çështja 5 - Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta

E gjetura Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna ka angazhuar 49 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ku janë identifikuar dobësi si në vijim:

- Në 28 raste periudha e angazhimit të zyrtareve është më i gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, mbi gjashtë muaj;
- Në tri raste komuna nuk ka zbatuar ndonjë procedurë të rekrutimit konform kërkesave ligjore; dhe
- Pagesat mujore për këta zyrtar, në asnjë rast nuk kanë të bashkangjitura dëshmi apo raport, për të verifikuar se janë realizuar apo pranuar shërbimet konform kontratës.

Rreziku Dobësitë e identifikuar mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara. Në mungesë të kontrolleve komuna rrezikon rritje të pa planifikuar të këtyre shpenzimeve që mund të ndikojnë në mos realizimin e objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në komunë (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave. Gjithashtu pagesat sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta të realizohen vetëm pasi të sigurohen dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e këtyre shërbimeve.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 ishte 1,012,652€. Prej tyre ishin shpenzuar 882,627€ apo 87% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me pagesat për komunal, udhëtime, telekomunikim, shërbime, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 48 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte tejkalluar dukshëm këtë numër në 67 aktivitete të realizuara. Disa nga aktivitetet nuk kanë qenë të planifikuara kryesisht kanë të bëjnë me kontratat me vlerë minimale. Kontrollat në këtë fushë në përgjithësi kanë funksionuar mirë. Në të gjitha mostrat e testuara ishin caktuar menaxherët e kontratave dhe puna e kryer ishte konfirmuar para çdo pagese.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 296,915€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 262,018€ apo 88% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,707,603€. Prej tyre në 2017 komuna ka shpenzuar 2,070,342€. Ato kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës, ndërtim të objekteve, asfaltim të rrugëve, kanalizim pajisje, betonim të kanaleve të ujitjes, përmirësime të ndryshme të kapitalit e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 76 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte realizuar 88 aktivitete, ose 12 më shumë në raport me planifikimin. Diferenca rrjedh sepse aktivitetet të cilat janë financiar nga organizatat tjera buxhetore nuk kanë qenë të planifikuara. Në të gjitha rastet komuna kishte konfirmuar punën e kryer para çdo pagese, po ashtu për mbikëqyrjen e punimeve ishte angazhuar një kompani e jashtme.

Çështja 6 - Hyrja në obligime pa disponueshmëri të mjeteve buxhetore

- E gjetura** Komuna ka filluar ndërtimin e 10 shtëpive sipas projektit “Ndërtimi i shtëpive për të pastrehët në Komunën e Istogut”, duke tejkalluar buxhetin në dispozicion prej 95,000€. Kontrata e nënshkruar me 13/07/2017 përcakton vetëm çmimin për njësi/shtëpi në vlerë 10,679€, por nuk specifikon numrin e shtëpive që duhet ndërtuar.
- Rreziku** Hyrja në obligime pa mbulesë buxhetore është në kundërshtim me LMFPD dhe rrit rrezikun që komuna të paguajë ndëshkime mbi vonesat, duke shkaktuar kështu vështirësi buxhetore për vitet pasuese.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se komuna disponon fondet e mjaftueshme para hyrjes në obligime kontraktuale dhe kërkesat për paramasat dhe parallogaritë janë specifikuar sipas nevojave dhe në përputhje me rregullat e prokurimit.

Çështja 7 - Mangësi në vendosjen e kriterëve tek aktiviteti i prokurimit

Te aktivitetit i prokurimit “Mbikëqyrja e projekteve kapitale” në njoftimin për kontratë të datës 10/03/2017 tek neni III.2.4 kapaciteti teknik dhe profesional, një nga kërkesat ishte që menaxheri i projektit të kishte përvojë pune tre vjeçare. Megjithatë tek dëshmitë e kërkuara nuk ishte specifikuar lloji i dëshmive të kërkuara për të dokumentuar përvojën e punës, prandaj komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave kishte pranuar si dëshmi të përvojës së punës vetëm CV-in, pa siguruar dëshmi të mjaftueshme për të dokumentuar përvojën e punës, si dhe kishte lidhur kontratë më të njëjtin. Si pasojë kontrata ishte lidhur me Operatorin Ekonomik (OE) të pa përgjegjshëm në aspektin e kërkesave të teknike dhe profesionale.

- Rreziku** Mos specifikimi dokumenteve për të dëshmuar përvojën e kërkuar të punës dhe vlerësimi i përvojës së punës bazuar vetëm në CV-në e ofruar nga OE, rrit rrezikun që stafi i angazhuar në projektin përkatës të mos ketë përvojën e duhur profesionale dhe si rrjedhojë mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë se kontrolle shtesë tek zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit. Fillimisht kriteret e përcaktuara duhet të jenë të qarta, e me pas të komisioni për vlerësim të ofertave të bëjë një vlerësim objektiv në përputhje me to.

Çështja 8 – Mosrespektim i procedurës për konfiskimin e sigurisë së tenderit

- E gjetura** Tek aktiviteti i prokurimit për ndërtimin e rrugës lokale “Selman Tahirsylaj” në fshatin Lluga, komuna nuk ka konfiskuar sigurinë e tenderit nga operatori i cili është tërheq nga tenderimi pasi komisioni vlerësues e kishte rekomanduar për lidhje të kontratës. Vlera e sigurimit të tenderit ishte 3,000€. Pra nuk është përmbushur kërkesa ligjore sipas Udhëzuesit Operativ nenit 29.8 dhe komuna nuk ka ofruar arsye për këtë situatë.
- E gjetura** Mangësitë e identifikuara ndikojnë në reputacionin e komunës dhe mund të rezultojnë me vonesa apo shpenzime shtesë, për shkak të mos aplikimit të masave ligjore për operatorët ofertues jo serioz.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë se kontrolle shtesë për zbatimin e procedurës së konfiskimit të sigurisë së ofertës në rastet e përcaktuara me rregulla dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik.

Çështja 9 – Nënshkrimi i kontratave pa mbulesë të fondeve për vitin pasues

- E gjetura** Në dy raste komuna ka nënshkruara kontrata në fund të vitit pa fonde të buxhetuara edhe për vitet e ardhshme. Kontratat: “Asfaltimi i rrugës lokale Selmon Tahirsyla, fshati Lluga” me 29/11/2017 me plan dinamik 60 ditë, si dhe “Betonimi i kanalit të ujitjes Vrell – Prigode” me 13/11/2017 me plan dinamik 50 ditë pune. Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Buxhetit nuk lejohet nënshkrimi i kontratave në fund vit për projekte, shpenzimet e të cilave pritet të behën në vitin e ardhshëm. Përgjithësisht bëjnë vetëm rastet kur buxheti për një projekt të tillë është planifikuar edhe për vitet e ardhshme.
- Rreziku** Kontratat për projektet të cilat nuk mund të përfundojnë në vitin aktual dhe potencialisht do të kenë shpenzim të pa planifikuar edhe në vitin e ardhshëm, rrisin rrezikun e dështimit të tërësishëm të projektit apo rritjen e obligimeve pa mbulesë.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se komuna merr obligime kontraktuale konform fondeve të buxhetuara vjetore dhe sipas rregullave. Kontrollat adekuate duhet të funksionojnë para nënshkrimit të kontratave e sidomos në periudhën e fund vitit.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 10 - Mosrespektim i legjislacionit përkatës në formimin e komisioneve të vlerësimit.

E gjetura Komuna e Istogut në fillim të vitit 2017 ka aprovuar një listë të stafit prej 20 anëtarësh të cilët janë angazhuar sipas nevojës në komisione të ndryshme, qoftë të hapjes apo vlerësimit pa ndonjë vendim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Sipas nenit 40 të rregullës dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik, komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast nga Zyrtari Kryesor Administrativ me rekomandim nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

Më tutje, numri i anëtarëve që marrin pjesë në komisionet e vlerësimit duhet të jetë tek dhe jo më pak se tre vetë. Në një rast komisioni i vlerësimit përbëhej nga katër anëtar në kundërshtim me rregullat e lartpërmendura.

Rreziku Mos formimi i komisioneve prej rastit në rast siç kërkohet me rregullat dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik rrit rrezikun që anëtarët e caktuar në komisionet përkatëse të mos jenë kompetent për punën e caktuar.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit komisionet përkatëse formohen prej rastit në rast me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik.

Çështja 11 - Pagesa pa dëshmi të mjaftueshme

E gjetura Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në dy (2) rastet në vijim ishin realizuar pagesa pa siguruar dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve:

- Pagesa në vlerë 638€, për “Krijimin e sistemit të unifikuar të adresave në komunën e Istogut” është realizuar pa dëshmi për realizimin e shërbimeve; dhe
- Pagesa në vlerë 15,000€ për “Mirëmbajtën e rrugëve lokale të rendit të katërt në Komunën e Istogut” është realizuar bazuar në raportin e përgatitur nga komisioni për punët e kryera, sipas të cilit kompania ka bërë shtrimin e rrugëve me zhavorr në lokalitete të ndryshme të komunës, por nuk tregohet saktësisht se cilat rrugë si dhe sasinë e punëve të realizuara.

- Rreziku** Pagesat në mungesë të dëshmimeve apo mos definimi i punëve, shërbimeve të pranuar rrit rrezikun e pagesave në mungesë të furnizimit apo furnizimit jo në përputhje me kontratën. Kjo mund të ndikoj edhe në dëmtim të buxhetit.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmimeve të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 16,147,730€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 137,841€.

Çështja 12 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

- E gjetura** Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që raporti i inventarizimit të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komuna në fund të vitit ka themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur ta përfundoj këtë proces para përgatitjes dhe dorëzimit të PFV-ve.
- Rreziku** Angazhimi jo i duhur për azhurnimin e regjistrimit të pasurisë reflekton mungesë të informatave të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim. Kjo rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

3.9 Të arkëtueshmet

Komuna e Istogut ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë totale 1,189,600€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 922,000€, leje ndërtimi 55,630€, ngarkesa për afarizëm të bizneseve 175,000€, ngarkesa për shërbime të pijeve alkoolike 8,000€, si dhe qiraja komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 28,970€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 është prezantuar 122,635€. Këto janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Hyrja në obligimeve kryesisht ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mira sa i përket raportimit dhe pagesës së obligimeve.

Çështja 13 - Vonesa në pagesën e faturave dhe mos raportim i obligimeve

E gjetura Komuna në shtatë pagesa, në vlerë totale 12,772€, ishte vonuar në pagesën e faturave/obligimet ndaj furnitorëve. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, përcakton afatin e pagesës brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës.

Gjithashtu komuna e Istogut gjatë vitit 2017 nuk ka raportuar fare obligimet e papaguara në MF, kërkesë e Rregullores Nr. 02/2013, që obligon komunën të raportoj në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara.

Rreziku Kontrollat jo të mira në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve rrisin rrezikun e hyrjes në obligime pa mbulesë buxhetore apo përballje me drejtësinë duke krijuar edhe shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimi të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Istogut ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Komuna e Istogut kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, vetëm katër (4) rekomandime janë zbatuar plotësisht, katër (4) ishin në proces të zbatimit, ndërsa tetë (8) nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 13 rekomandime, dhe në vitin 2017, një (1) nga to është zbatuar, dy (2) rekomandime tjera janë në zbatim e sipër dhe 10 nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake - Prioritet i lartë

E gjetura Megjithëse, komuna ka hartuar me kohë planin e veprimit, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të ndikojë në dobësi në menaxhim dhe raportim të shpenzimeve.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna e Istogut gjatë vitit 2017 ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, megjithatë ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Megjithatë, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive si mungesa e planit strategjik për menaxhimin e rrezikut, monitorim jo adekuat në zbatimin e plotë të rekomandimeve të ZKA-së dhe NjAB-së, mungesa e sistemit për menaxhimin e rreziqeve, si dhe raportimi i dobët menaxherial.

Komuna e Istogut, kishte hartuar strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal për periudhën 2017 -2021. Po ashtu kishte hartuar planet urbanistike, planin operativ emergjent si dhe planin strategjik kundër korrupsionit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor, Drejtori i njësisë. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. NjAB ka hartuar Planin strategjik, dhe Planin vjetor të punës dhe Komiteti i Auditimit (KA) po ashtu ka mbajtur takime të rregullta gjatë vitit 2017. Nga katër auditimet sa ishin planifikuar, tri janë përfunduar gjatë vitit 2017. Auditimet e NjAB-it kanë mbuluar: menaxhimin e pasurisë (fushëveprimi 2016), menaxhimin e departamentit të shëndetësisë (fushëveprimi 2016/2017) dhe menaxhimin e tatimit në pronë për vitin 2017.

Çështja 15 – Funksionimi i kufizuar i NjAB-së dhe KA-së

- E gjetura** Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:
- Njësitë e audituara nuk kanë hartuar plane për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së dhe kjo ka rezultuar me një nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Nga gjithsej 21 rekomandimet e dhëna, gjashtë (6) ishin zbatuar, tetë (8) ishin në proces të zbatimit ndërsa pjesa tjetër nuk është zbatuar ende. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet të zbatohen nga komuna me kohë; dhe
 - Komiteti i auditimit ka mbajtur katër (4) takime ku janë diskutuar raportet e NjAB dhe ZKA-së. Sidoqoftë, KA nuk ka qenë mjaftueshëm efektiv në përmbushjen e mandatit për të mbikëqyrur rezultatet e NjAB-së dhe ofrimin të kontributit në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm nga menaxhmenti.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve zvogëlon efikasitetin dhe ndikimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm në përmirësimin e qeverisjes së përgjithshme.
- Rekomandimi 15** Kryetari në bashkëpunim me KA-në dhe NjAB-së duhet të ndër marr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 16 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta javore, formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore. Si pasojë e kontrolleve jo të mira janë vërejtur dobësi në fushën e prokurimit, pagesën e shpenzimeve, në regjistrimin e pasurisë si dhe në raportimin e obligimeve.

Komuna e Istogut gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2016-2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënëse për keq klasifikim të shpenzimeve dhe pasuritë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave. Gjithashtu, raportimi dhe komunikimi do të përmirësojnë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave eventuale.			Nuk janë marrë masa.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se rreziqet do të identifikohen përmes një regjistri, ku do të vlerësohet niveli i rrezikut, gjasat që rreziqet të ndodhin si dhe masat adekuate si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve. Më tej, një zyrtar i lartë i komunës duhet të përkujdeset për zbatimin dhe monitorimin sistematik.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të diskutoj një plan veprimi me nivelet tjera menaxhuese dhe të përcaktoj stafin përgjegjës dhe afatet për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm. Një proces monitorimi mbi progresin, gjithashtu duhet të vendoset. Në identifikimin e çështjeve për trajtim, NJAB duhet të fokusohet më shumë në aktivitetet e vitit aktual, me prioritet në fushat ku rreziku vlerësohet i nivelit të lartë.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar në rastet e mësipërme dhe të implementohen kontrole të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëritet në të ardhmen.		Kishte progres, megjithatë ende nevojiten veprime shtesë për eliminimin e plotë të dobësive në prokurim.	

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikrat e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimit të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie., Më tutje, kontratat për shërbime të veçanta të përdoren për qëllime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 6 muaj siç e përcakton ligji. Ne sugjerojmë që praktikrat e tilla të mos përsëriten.		Pjesërisht e zbatuar, edhe me tutje mbetet për tu adresuar çështja e angazhimit të stafit me kontrata për shërbime të veçanta.	
3.5.1 Kompensimet pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të rishikoj çështjen e pse këto parregullsi në proces kanë ndodhur dhe po përsëriten vite me radhë, dhe të siguroj që në sistemin e pagave nuk do të procedohen pagesa në bazë të kontratave fiktive.	Po		
3.6 Të hyrat vetjake	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Të hyrat vetjake	Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandeve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale, në mënyrë që ketë një proces të hapur dhe transparent, si dhe të shtojë mekanizmat si dhe të ushtroj monitorim të vazhdueshëm tek shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë që ato të mos shfrytëzohen pa kryer paraprakisht obligimet sipas rregullores komunale.			Nuk janë marrë masa.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar, dhe më pas, të gjitha pasuritë të prezantohen drejt në PVF. Të sigurojë se implementohen kontrole adekuate për të siguruar që përdorimi i automjeteve menaxhohet për nevoja zyrtare.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj që raportimi i obligimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore dhe të ndërmer masa që faturat të paguhen brenda afateve ligjore.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Më pas, duhet të ndërmer veprimet e duhura që të regjistroj të gjitha pasuritë në regjistrat përkatës të pasurive dhe t'i korrigjoj gabimet aktuale në regjistrat kontabël për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive dhe shpalosje të plotë llogarive të arkëtueshme.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.			Nuk janë marrë masa.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Auditimi i brendshëm duhet të përfshihet në procesin e rishikimeve përfundimtare për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Komuna ende nuk kishte ndërmarrë masa për adresimin dobësive të identifikuara në pyetëtorin e vetëvlerësimit.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të hartoj me kohë dhe propozoj për miratim në asamblenë komunale planet strategjike për zhvillimin e komunës duke vendosur, objektiva strategjike dhe duke mbikëqyrur dhe matur realizimin e tyre në baza të rregullta		Ende nuk është aprovuar strategjia e zhvillimit rajonal në asamblenë komunale.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.			Nuk janë marrë masa.
2.4 sistemi i auditimit të Brendshëm	Kryetari duhet të punoj me drejtorin e NJAB-it për të siguruar rishikime të mjaftueshme për vitin aktual mbi sistemet financiare. Në vitet e ardhshme, përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NJAB-it duhet të monitorohet në baza të vazhdueshme dhe të ndërmerren veprime veprime në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar apo të rishikuar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		Për shkak të mungesës së rishikimit buxhetor në vitin 2017 supozimet e buxhetit fillestar edhe pse ishin të pasakta nuk kishin mundur ndryshoheshin.	

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se dhënia me qira e pronës komunale të bëhet konform Rregullores Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës i shqyrtojnë me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe i lëshojnë vendimet përkatëse brenda afateve ligjore.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh udhëzimi administrativ në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj që plani i prokurimit është hartuar në bazë të nevojave reale, realizimi bëhet në pajtim me planifikimin dhe fondet e duhura për realizimin e kontratave janë zotuar para nënshkrimit të kontratës.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë që respektohet ligji dhe kontratat lidhen në pajtim kërkesat në dosjet e tenderit.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor dhe i njëjti të harmonizohet me situacionet për të verifikuar saktësinë e punëve të kryera dhe shumat e pagesave. Menaxherëve të projekteve t'u qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me Ligjin e ndërtimit Nr. 04/L -110) si dhe UA 15/2013 i MMPH mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor.	Po		

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e planifikimeve fillestare të buxhetit, shpenzimet të planifikohen, shpenzohen dhe regjistrohen në kategoritë ekonomike adekuate sipas planit kontabël.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj që regjistrat e pasurive të jenë të plota dhe të sakta, dhe për dobësitë identifikuar gjatë inventarizimit, të merren veprime konkrete për përmirësim në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurisë.		Në regjistrin e pasurisë nuk janë regjistruar ende 1,540 parcela të tokës komunale, dhe regjistri i pasurisë nën 1,000€ (e-pasuria) nuk është përditsuar ende me të dhënat e pasurive të viteve paraprake në sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit dhe inventarizimi nuk ishte kryer në kohën e duhur.	
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj që faturat e pranuar të ekzekutohen brenda afatit të paraparë ligjor dhe obligimet e papaguara të raportohen sipas afateve kohore të përcaktuara me rregulloret financiare.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi


REPUBLICA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLICA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Uales-Izlazna
Nr: 01-016-22970 Data 10.05.2018
Br: Datum
ISTOG-ISTOK



Komuna e Istogut

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të ZKA, në Raportin e auditimit për vitin
2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Haki Rugova
Kryetar i Komunës,

Data: 10.05.2018, Istog

